



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 150/2020

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN
DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pika 6, pas fjalëve "korrupsionit pasiv," shtohen fjalët "përfshirë edhe korrupsionin aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje,".

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1

Njësia përgjegjëse në KQZ

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve krijohet dhe funksionon njësia përgjegjëse për marrjen dhe trajtimin e sinjalizimeve në fushën e korrupsionit aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Njësia përgjegjëse në KQZ, në përfundim të hetimit administrativ, në rast se konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji për sinjalizimet në fushën e veprimtarisë zgjedhore, të cilat nuk përbëjnë vepër penale, vendos masë administrative me gjobë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

3. Nëse në përfundim të hetimit administrativ njësia përgjegjëse në KQZ arrin në përfundimin se veprimi ose praktika e dyshuar, e sinjalizuar, e korrupsionit aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje ka elemente të veprës penale, njofton menjëherë prokurorinë.”.

Neni 3

Në pikën 2 të nenit 23 kudo pas emërimit “ILDKPKI” shtohen fjalët “ose njësia përgjegjëse në KQZ”.

Neni 4

Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që në përputhje me udhëzimet e ILDKPKI-së, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë rregulloren e parashikuar në nenin 13, pika 10, të ligjit.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 17.12.2020